



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal off Kacanik
01Nr. 16-714-8763/2014
Kaçanik, 31.03.2014



Në bazë të nenit 5, 17(b) të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit 04/L-110 për Ndërtim, të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, të Planeve Zhvillimore të Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PARCELËS KADASTRALE 664 TË ZONËS KADASTRALE KAÇANIK NGA PLANI ZHVILLIMOR URBAN I KAÇANIKUT

I.

Me këtë Vendim bëhet ndërrimi i destinimit të parcelës kadasrale 664 të zonës kadastrale Kaçanik, nga Plan i Zhvillimor Urban i Kaçanikut, nga destinimi; Shërbime dhe Banim Individual, në Zonë për Banim Kolektiv dhe Afarizëm.

II.

Ndërrimi i destinimit të Parcelës Kadastrale 664 e Zonës Kadastrale Kaçanik, nga Plan i Zhvillimor Urban, nga destinimi -Shërbime dhe Banim Individual P+1 deri P+2, kalon me destinim: Ndërtesa për Banim Kolektiv dhe Afarizëm, B+P+5 (e paraqitur si në Planin ideor të pronarit të tokës Avdyl Gula, i cili Plan do të jetë pjesë përbërse e këtij Vendimi).

III.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

V.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Arkiva.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës Kaçanik në bazë të Kërkesës së DUKMM, iu ka drejtuar Kuvendit të Komunës me Propozim Vendim 01Nr. 714-8763/14 prej datës 21.03.2014, Për ndërrimin e destinimit të parcelës kadastrale 664 të Zonës Kadastrale Kaçanik. Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 31.03.2014, duke u nisur nga arsyetimet e organit profesional, Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, se për këtë parcelë është ofëruar një Plan Ideor shumë i arsyeshëm nga pronari Avdyl Gula, prona shtrihet pranë një rruge kryesore, në afësi të kësaj prone gjenden objekte kolektive dhe shtetërore, se ndërtimi i një objekti të tillë ndikon në zhvillimin ekonomik të komunës tonë, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2014, i mori për bazë të gjitha këto arsyetime të organit në fjalë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi